

Mos bini pre e tregëtisë së paligjshme të njerëzve

**Vende pune në
Kanada.
500 dollarë në Javë!**

**Vende pune
në Kanada!**

“Unë mund t’iu siguroj punë në Kanada”

**Vende pune të
garantuara
në Kanada!**

**Diploma nuk është
e nevojshme**

Ëndrra

Kur dikush iu ofron ndihmë për të ardhur në Kanada mund t'iu premtojë mundësi të shumta që do t'iu jepen këtu dhe gjithë ato para që do të jeni në gjendje të fitoni. Do t'iu tingëllojë shumë bukur.

TRAFIKU I NJERËZVE ËSHTË I PALIGJSHËM. TRAFIKANTËT QARKULLOJNË NJERËZ NGA NJË VEND NË TJETRIN DHE I SHFRYTËZOJNË ATA DUKE I DETYRUAR TË PUNOJNË NË PUNË TË KËQIJA DHE, NGANJËHERË EDHE TË RREZIKSHME, ME ORAR TË ZGJATUR DHE PAGESA TË ULËTA OSE PA PAGESË. TRAFIKU ËSHTË TREGËTIA E SKLLEVËRVE E SHEKULLIT TË 21^{TË}.

Kujdes, ka njerëz që nuk janë të ndershëm dhe që trafikojnë njerëz.

Fatkeqsisht, shumë njerëz e kanë kuptuar tepër vonë se premtimet e dhëna nga trafikantët s'janë qënë gjë tjetër veçse gënjeshtër.

Ne kemi pasur rastin të takojmë njerëz nga të katër anët e botës. Ja ç'u ka ndodhur atyre kur janë sjellë në Kanada nga trafikantët.

- Kanë qënë në vëzhgim gjatë gjithë kohës dhe nuk kanë pasur mundësi të dalin sipas dëshirës.
- Janë detyruar të bëjnë seks të pambrojtur dhe të rrezikshëm, me njerëz të panjohur.
- Janë kërcënuar, rrahur, përdhunuar ose ndëshkuar.
- Nuk janë paguar për punën e bërë.
- Iu është ndaluar të flasin me njerëz të tjerë ose të shoqërohen me kanadezë.
- Iu është thënë se do të jenë të detyruar të punojnë derisa të shlyejnë borxhin, ndërkohë që borxhi ka ardhur duke u shtuar dhe jo duke u pakësuar.
- E kanë pasur të pamundur të shpëtojnë sepse kanë pas qënë të detyruar të shkelin ligjin dhe, për rrjedhorë, kanë pasur frikë.
- Familjet në vendet e tyre ua kanë kërcënuar me ushtrim dhune dhe pasoja të tjera.

Është tepër e vështirë t'iu shpëtosh trafikantëve. Ata e dijnë mirë si t'i frikësojnë dhe dobësojnë njerëzit. Ata e dijnë mirë si t'i mbërthejnë të tjerët në situata pa rrugëdalje. Ju lutem, jeni të kujdesshëm. Ata që përfitojnë nga puna juaj janë trafikantët dhe ata s'kanë ndërmend t'iu lenë që t'iu ikni nga duart

shen futur në burg. Ne nuk jemi kafshë - madje edhe kafshët janë të lumtura.”

- Citim nga një viktimë trafikut sjellë në Kanada

Mesazh nga Qeveria e Kanadasë

Dëshira juaj për të ardhur në Kanada na jep kënaqësi. Ne jemi krenarë për vendin tonë dhe për gjithçka ai është në gjendje t'i ofrojë qytetarëve të tij, të porsaardhurve dhe vizitorëve.

Kanadaja ka procedura të caktuara, të cilat duhet ndjekur nëqoftëse dikush dëshiron të vijë si imigrant, si punëtor i përkohshëm, si student apo si vizitor. Gjithashtu kemi procedura të veçanta për mbrojtjen e refugjatëve, të cilët janë në rrezik dhe të detyruar të arratisen nga vendet e tyre. Nëqoftëse doni të vini në Kanada, ju lutemi ndiqni rregullat e këtij vendi.

Duhet ta dini se Kanadaja i është bashkuar shumë vendeve të tjerë në mbarë botën në përpjekjet për të ndaluar trafikun e njerëzve. Trafikantët rekrutojnë njerëz duke iu premtuar atyre punë të mira në vende si Kanadaja, dhe pastaj i detyrojnë të punojnë në kushte të rrezikshme dhe poshtëruese. Trafikantët i gënjejnë njerëzit për punët që do të bëjnë, i detyrojnë të punojnë me pagesa të ulëta ose pa pagesë fare, i kontrollojnë që të mos iu shpëtojnë dhe, nganjëherë, i shesin te një palë e tretë.

Ne kemi ligje të ashpra dhe dënime me burg për trafikantët. Nuk do të donim kurrsesi që Kanadaja të bëhej pjesë e kësaj tregëtije skllëvërisht të kohëve moderne.

Zyra kanadeze e imigracionit në vendin tuaj mund t'iu shpjegojë të gjitha rrugët se si të vini ligjërisht në Kanada. Ambasada ose Konsullata kanadeze pranë jush mund t'iu drejtojë për në zyrën më të afërt kanadeze të imigracionit.

Për të punuar në Kanada ju duhet leje pune

Të huajt që udhëtojnë për në Kanada me plane për të punuar aty, duhet të jenë të pajisur me leje pune. Për lejen e punës ju ose punëdhënësi juaj duhet t'i bëni kërkesë zyrës kanadeze të imigracionit në vendin tuaj që para se të niseni për në Kanada. Nëse keni ndërmend të punoni në Kanada, lejen e punës duhet ta keni me vete në çastin kur mbërrini aty. Nuk mund të vini në Kanada si vizitor dhe pastaj të filloni punë.

Ligje për ndalimin e trafikut

Kanadaja dhe vendet e tjera duan që të mos i lejojnë trafikantët të qarkullojnë burra, gra e fëmijë nga një vend në tjetrin për qëllime të paligjshme. Këta kriminelë, në vend që të shesin drogë, shesin njerëz. Trafikantët iu premtojnë njerëzve se do t'iu jepet punë e mirë në vendet ku do të shkojnë dhe do të jetojnë një jetë më të mirë dhe fitojnë shumë më tepër para se sa në vendet e tyre. Por nuk ndodh kështu.

Këta kriminelë i detyrojnë njerëzit që të punojnë në punë të këqija dhe të rrezikshme, me orare të zgjatura dhe duke u paguar shumë më pak nga ç' meritojnë. Ata mund edhe t'i ndëshkojnë ata njerëz që nuk iu binden ose që përpiqen të shpëtojnë prej tyre. Ata mund të hakmerren ndaj familjeve që keni lënë pas, me qëllim që të mos iu lenë ta braktisni punën. Mund t'iu bëjnë presion që të merrni drogë dhe të shkëlmi ligjin. Ata iu kërcënojnë që të mos keni guxim të shpëtoni nga gjendja ku keni rënë. Ju s'jeni tjetër veçse robër të tyre.

Kjo shitje dhe ky kontroll njerëzish janë të paligjshme në Kanada dhe në shumë vende të tjerë të botës.

Në Kanada, në qoftëse provohet se dikush është fajtor për trafikun e njerëzve, mund të gjobitet deri në 1,000,000 dollarë ose të dënohet me burgim të përjetshëm.

Ligjet kanadeze

Në Kanada konsiderohen krim:

krime dhune

- goditja, shkelmimi, grushtimi, pickimi, apo rënia me shuplakë dikujt, duke përfshirë edhe bashkëshorten ose bashkëshortin
- kërcënimi për t'iu ndëshkuar ju, fëmijën tuaj, një anëtar të familjes apo një shok/shoqe
- mbajtja e dikujt në një vend dhe ndalimi i këtij njeriu për të lëvizur dhe për të takuar të tjerë
- marrëdhëniet seksuale me dikë që nuk pranon të ketë marrëdhënie të tilla, duke përfshirë edhe bashkëshortin apo bashkëshortin

krimet e seksit dhe të drogës

- kur pyet dikë në një vend publik nëse dëshirojnë të bëjnë seks me ju për para
- të qënit në një vend ku njerëzit paguajnë për të bërë seks
- të jetuarit me para që fitohen duke shitur shërbime seksuale
- të detyruarit e dikujt për të bërë seks me dikë tjetër, kur nuk dëshiron të bëjë
- blerja e shërbimeve seksuale nga dikush që është nën moshën 18 vjeç
- mbajtja e drogave të paligjshme si marijuana, hashish, kokainë dhe heroinë si dhe dhëni, shitja apo transportimi i drogave të paligjshme te dikush.

Në Kanada ka ligje për mbrojtjen e punëtorëve. Është e kundraligjshme:

- të detyrosh dikë të punojë pa pagesë
- të detyrosh dikë të punojë për ditë të tëra pa pushim
- të detyrosh dikë të punojë në vende të rrezikshme pune ku mungojnë kushtet e sigurimit të punës

Kanadaja e merr shumë seriozisht ndalimin e trafikut të njerëzve. Ju mund të ndihmoni. Mos ejani në Kanada në mënyrë të paligjshme dhe mos punoni këtu në punë të paligjshme. Nëqoftëse arrini të vini në Kanada dhe përfundoni duke bërë punë të paligjshme ose ndonjë punë ku punëdhënësi i kontrollon dhe ju trajton si skllav, telefonojini policisë. Tregojini ç'po ndodh me ju. Kjo mund të jetë e vetmja rrugë për të shpëtuar nga gjendja. Por jini të kujdesshëm. Punëdhënësit e pandershëm dhe kriminelët që trafikojnë njerëz janë të rrezikshëm dhe bëjnë çështje e mundur për të mos iu lejuar të flisni me policinë.

Edhe fëmijët rrezikohen

Nganjëherë, trafikantët përpiqen të blejnë fëmijë nga prindërit e tyre ose t'i bindin prindërit t'i dërgojnë fëmijët larg, në mënyrë që ata të mund të fitojnë para për familjen. Adoleshentët që largohen nga shtëpia mund të bijen shumë lehtë pre e trafikantëve.

Fëmijët dhe adoleshentët në të shumtën e rasteve trafikohen në tregëtiti e seksit dhe të drogës.

Pyetje - Përgjigje

Pyetje: Nuk jam i sigurt nëse mund t'i besoj atij njeriu që po më ofron një punë në Kanada. Ç'duhet të bëj?

Përgj.:

(1) Kij kujdes. Në Kanada kemi një proverb: Po t'u duk shumë e mirë për të qënë e vërtetë, ka të ngjarë të mos jetë." Mos u mashtroni nga premtimet për para. Mund ta pësoni dhe të katandiseni ta paguani gabimin me jetën tuaj.

(2) Mos jepni asnjë të dhënë për familjen dhe adresën e tyre. Kriminelët mund t'i përdorin këto të dhëna për t'iu detyruar të bëni gjëra që nuk doni t'i bëni. Nëse vini në Kanada dhe përpiqeni të shpëtoni prej tyre, ata mund të hakmerren me fëmijët tuaj, apo me prindërit ose me anëtarë të tjerë të familjes që keni lënë pas në atdhe, në mënyrë që të jenë në gjendje t'iu kontrollojnë.

(3) Përpiquni të merrni sa më shumë të dhëna për njeriun që iu ofron punë, për punën dhe për adresën dhe vendin e punës. Jini gjithmonë dyshues nëqoftëse iu thonë se këto lloj të dhënash janë sekrete.

(4) Përpara se të largoheni, jepini familjes dhe miqve tuaj të gjitha të dhënat që keni për njerëzit që po iu ndihmojnë për të

"Mos iu besoni gënjeshtreve. Unë s'kam as liri, as para, as lumturi... Qëndroni në shtëpi – të paktën aty do të keni familjen dhe respektin për veten."

- Citat nga një viktimë trafiku.

shkuar në Kanada, për punën dhe për vendin ku do të shkoni të punoni.

Pyetje: Më kanë ofruar një vend pune si "argëtues" (entertainer). Çfarë pune do të bëj?

Përgj.:Së pari, duhet të pyesni njeriun që ua ofron punën se çfarë saktësisht pritet nga ju që të bëni. Përpiquni të nënshkruani një kontratë me këtë njeri. Në kontratë duhet të shkruhet se çfarë pune do të bëni, ku do ta bëni atë dhe sa do të paguani për atë punë.

Fjala "Argëtues" mund të jetë një mënyrë për të thënë se do të punoni në tregëtinë e seksit. Në tregëtinë e seksit, disa punë janë të ligjshme, për shembull, të vallëzosh lakuriq, pa u prekur me kërkënd. Por në këtë tregëti, shumë punë janë të paligjshme, për shembull, puna në një shtëpi ku njerëzit paguajnë para për të bërë seks.

Pyetje: Sa kohë jam i detyruar të punoj për punëdhënësin që më ka sjellë në Kanada?

Përgj.:Asnjë punëdhënës nuk ka të drejtë t'iu detyrojë të qëndroni në një punë të caktuar. Por, ka punëdhënës të pandershëm që bëjnë çështje e mundur që ju të mos shpëtoni dot prej tyre. Ose, mund t'iu kërcënojnë duke thënë se do t'iu dërgojnë mbrapsh, në vendin nga keni ardhur ose do t'iu ndëshkojnë ju apo familjen tuaj nëqoftëse largoheni nga puna që iu japin.

Pyetje - Përgjigje

Pyetje: Më kanë thënë se nga ajo punë do të arrij të fitoj shumë më tepër para se sa bëj këtu për gjashtë muaj. Është e mundur?

Përgjigje: Ka shumë të ngjarë që jo. Punëdhënësit e pandershëm gënjajnë për shumën e parave që do t'iu paguhet dhe do të gjejnë mënyra për t'iu detyruar t'ua ktheni gati të gjitha paratë që fitoni. Do t'iu thonë se jeni të detyruar t'i paguani për ushqimin, për vendin ku flini, për shpenzimet e ardhjes në Kanada. Gjithashtu, në Kanada gjërat janë të shtrenjta. Mund t'iu duket si shumë para, por në të vërtetë do ta kuptoni se nuk janë aspak të mjaftueshme për të gjetur një vend të mirë për të jetuar dhe për ushqim.

Pyetje: Kur të mbërrij në Kanada, a do të jem në gjendje të udhëtoj në Kanada dhe në Shtetet e Bashkuara?

Përgjigje: Kur të vini në Kanada në mënyrë të ligjshme dhe po të keni pasaportë e leje pune mund të udhëtoni lirisht në të gjithë Kandanë. Do t'iu duhet t'i drejtoni kërkesë qeverisë së Shteteve të Bashkuara për leje që të hyni në Shtetet e Bashkuara. Janë Shtetet e Bashkuara ato që do të vendosin, sipas rregullave të tyre, nëse mund të shkoni apo jo në Shtetet e Bashkuara.

Njerëzit që merren me trafik njerëzish mund të përpiqen t'iu pengojnë të qarkulloni duke iu marrë pasaportën dhe lejen e punës. Kjo është një nga mënyrat që përdorin trafikantët për

“Të gjithë ditët janë njëlloj, s’kam liri, s’kam të drejtë të veproj si dua. E vetmja e drejtë që më jepet është të shes trupin tim, përndryshe nuk mund të mbijetoj.”

Citat nga një viktimë trafiku.

t'iu mbajtur të mbërthyer në një vend ku nuk doni të qëndroni dhe për t'iu detyruar të bëni punë që nuk doni ta bëni. Sigurohuni që ta mbani gjithmonë me vete pasaportën dhe lejen e punës. Mos lejoni asnjeri tjetër që t'ua mbajë ato.

Pyetje: A ka në vendin tim organizata që mund të më ndihmojnë për të marrë më shumë të dhëna?

Përgjigje: Në disa vende, organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut po punojnë për të mbrojtur njerëzit që këta të mos bijen pre e trafikantëve. Gjithashtu, organizatat e Kombeve të Bashkuara, si Organizata Ndërkombëtare e Punës, mund të kenë projekte në vendin tuaj.

Ky pamflet botohet nga Qeveria e Kanadasë.

Si gjindet ndihma në Kanada

Ja edhe disa gjëra që duhet t'i dini nëse gjendeni në Kanada nën kontrollin e trafikantëve.

9-1-1 Shërbimet e Urgjencës

Formoni numrin 9-1-1 në telefon në çdo qytet të Kanadasë dhe do të lidheni drejtpërdrejt me policinë, repartin e zjarrfikësve ose me shërbimin e ambulancës. Sistemi i tregon automatikisht njeriut që i përgjigjet telefonatës se ku ndodheni ju. Nuk ka nevojë të thoni gjë. Mund t'i tregoni atij që përgjigjet se ç'gjuhë flisni. Ka të ngjarë që atje të ndodhet dikush që flet gjuhën tuaj. Nëse jeni në gjendje të flisni sadopak anglisht ose frëngjisht, përpikuni të shpjegoni përse keni telefonuar. Njeriu që i përgjigjet telefonatës do të dërgojë menjëherë aty ku jeni policinë, shërbimin e zjarrfikësve ose të ambulancës.

Strehat e Urgjencës

Shumë qytete të mëdha dhe të vegjël kanë vende të sigurta ku mund të shkoni menjëherë nëqoftëse nuk keni se ku të jetoni ose në qoftëse jeni në rrezik dhe iu duhet një vend i sigurt për të jetuar. Numrin e telefonit mund ta gjeni në numeratorin telefonik, në bibliotekë ose mund ta merrni nga policia.

Shërbimi mjekësor hospitalor

Po të jeni të sëmurë, mund të shkoni të vizitoheni në ambulancë te mjeku ose në spital. Disa qytete të mëdha kanë klinika shëndetsore ku mund të merrni trajtim mjekësor pa qënë nevoja të jepni sqarime se kush jeni dhe çfarë punë bëni.

Ndihmë komuniteti

Në Kanada ka shumë grupe që ndihmojnë njerëzit në nevojë. Ka shërbime për raste përdhunimesh, shtëpi për gra të abuzuara, organizata për të porsaardhurit në Kanada, klinika ligjore për ata njerëz që nuk e përballojnë dot pagesën e avokatit, shërbime të veçanta për viktime të krimeve dhe grupe fetare që japin shërbime të ndryshme përkrahjeje. Njerëz nga vendi juaj që sot jetojnë në Kanada mund të mblidhen së bashku, të përkrahin dhe ndihmojnë njeri-tjetrin. Se si gjenden këto grupe, mund ta mësoni në qendrat e komunitetit, në bibliotekat publike, në numeratorin telefonik ose duke pyetur njerëzit.

Kushte të pandershme pune

Ligjet kanadeze kërkojnë që punëdhënësit t'iu paguajnë punonjësve një pagë minimale të përcaktuar dhe të sigurojnë disa përfitime të tjera nga puna. Çdo zyrë e Ministrisë së Punës mund t'iu japë të dhëna dhe ndihmë nëse nuk po paguheni ndershmërisht, nuk merrni lejen që iu takon ose nëqoftëse jeni të detyruar të punoni në kushte të rrezikshme pune.